UDHËZIM
Nr. 19, datë 3.8.2012

MBI RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE MES KONTROLLUESIT DHE PËRPUNUESIT NË RASTET E DELEGIMIT TË PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE DHE PËRDORIMIN E NJË KONTRATE TIP NË RASTET E KËTIJ DELEGIMI

(ndryshuar me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2012)

(i përditësuar)

Në mbështetje të shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 30 dhe pikës "f" të nenit 31 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

UDHËZON:

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave në lidhje me marrëdhënien mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave, si dhe miratimi i një kontrate tip që palët duhet të përdorin në rast të këtij delegimi. Kontrata tip është pjesë e aneksit I të këtij udhëzimi.

2. Ky udhëzim zbatohet nga të gjitha kompanitë, organizatat apo institucionet që, me qëllim përmbushjen e funksioneve të tyre të ligjshme, hyjnë në marrëdhënie me kompani të treta dhe nëpërmjet kontratës, bien dakord që këto kompani të kryejnë përpunimin e të dhënave personale për llogari të tyre. Zbatimi i këtij udhëzimi ka për qëllim të sigurojë paprekshmërinë e të dhënave personale në çdo hallkë të këtij përpunimi.

3. Për qëllim që të bëjnë më të lehtë zbatueshmërinë e këtij procesi, termat e përdorur në këtë udhëzim kanë kuptimet e mëposhtme:

"Kontrollues" është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci, kompani, organizatë apo institucion që mban, administron dhe kontrollon të dhëna personale dhe për qëllime të përpunimit të tyre hyn në një marrëdhënie kontraktore me një kompani të tretë, e cila në këtë rast quhet përpunues.

"Kontrata e përpunimit (*outsourcing*)" është akti në bazë të të cilit kontrolluesi i kërkon përpunuesit të kryejë për llogari të tij një pjesë të përpunimit të të dhënave personale.

"Përpunues" është ajo kompani e cila hyn në një marrëdhënie kontraktore me kontrolluesin, me qëllim përpunimin e të dhënave personale për llogari të kontrolluesit;

"Cenim i të dhënave personale" është cenimi i sigurisë së të dhënave që rezulton në shkatërrimin, humbjen, ndryshimin, përhapjen e paautorizuar ose ndërhyrjen te të dhënat personale të transmetuara, ruajtura apo përpunuara.

Në asnjë rast këto përkufizime nuk zëvendësojnë apo mbivendosin përkufizimet e parashikuara nga ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar.

4. Çdo kontratë përpunimi (*outsourcing*) që ka për qëllim përpunimin e të dhënave personale përmban dispozita që vendosin rregulla për përpunimin e të dhënave personale sipas legjislacionit shqiptar. Çdo kontratë e tillë parashikon çdo masë që merr përpunuesi për të siguruar mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave, si dhe hapat që do të ndërmerren në rast cenimi të të dhënave.

5. Gjatë funksioneve të tij për grumbullimin, mbajtjen apo çdo përpunim tjetër të të dhënave personale, kontrolluesi mund të hyjë në një marrëdhënie kontraktore sipas legjislacionit shqiptar. Kjo marrëdhënie kontraktore mund të bëhet me kompani shqiptare ose të huaja, të cilat i ofrojnë këto shërbime. Në mënyrë që të sigurojë një përzgjedhje të mirë të përpunuesit, kontrolluesi vlerëson sa më poshtë:

a) Të përzgjedhë një kompani me emër të mirë në këtë fushë, e cila ofron garanci të qëndrueshme që sigurojnë të dhënat personale që do të përpunohen;

b) Kontrata me shkrim e bërë me përpunuesin, të përmbajë dispozita të veçanta që rregullojnë mbrojtjen e të dhënave personale;

c) Në rast se përpunuesi është kompani e huaj, kontrolluesi sigurohet se vendet ku përpunuesi vepron janë pjesë e vendeve që ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme për të dhënat personale sipas legjislacionit shqiptar. Kontrolluesi vlerëson edhe rastet kur kompania e bën përpunimin me nënkontraktim. Kontrolluesi duhet të tregojë kujdes për të përcaktuar nivelin e mbrojtjes së të dhënave personale gjatë gjithë hallkave të procesit. *Kontrolluesi duhet t'i referohet listës së vendeve që ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme të miratuar me vendimin nr. 3, datë 20.11.2012 "Për përcaktimin e shteteve, me nivel të mjaftueshëm të Mbrojtjes së të Dhënave Personale" dhe aneksit 1 bashkëlidhur, miratuar nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.*

ç) Kontrolluesi kontrollon legjislacionin e vendit të origjinës së kompanisë përpunuese për t'u siguruar që kontrata ka fuqi në të dyja vendet;

d) Kontrolluesi sigurohet që përpunuesi ofron masa të përshtatshme mbrojtëse për të dhënat që do të përpunojë;

dh) Kontrolluesi sigurohet që, si pjesë e masave të përshtatshme mbrojtëse, përpunuesi kontrollon mjaftueshëm personelin që merret me përpunimin. Për këtë qëllim, kontrolluesi mund t'i referohet standardeve të sigurisë ISO-27000;

e) Përpunuesi raporton çdo shkelje të sigurisë dhe çdo çështje tjetër që ka interes për kontrolluesin, në mënyrë që:

i) Të garantojë zbatimin e legjislacionit, duke mbajtur standardet e duhura të sigurisë dhe duke bërë rregullime pas çdo shkeljeje të mundshme të saj;

ii) T'i lejojë kontrolluesit të ketë mundësi t'i japë informacion subjektit të të dhënave, nëse ai e kërkon diçka të tillë.

6. Në rastet kur përpunuesi do të bëjë përpunimin e të dhënave, duke nënkontraktuar një kompani tjetër, kompania nënkontraktuese është subjekt i të njëjtave rregulla të mbrojtjes së përshtatshme, të parashikuara në pikën 5 të këtij udhëzimi. Çdo kontratë nënkontraktimi bëhet me shkrim dhe përmban:

a) miratimin paraprak të kontrolluesit;

b) verifikimin paraprak të kontrolluesit se kompania nënkontraktuese ka të njëjtin nivel sigurie si ai i kompanisë së kontraktuar.

Në asnjë rast nënkontraktimi, nuk mund të ketë një nivel sigurie më të ulët se sa ai i përcaktuar mes kontrolluesit dhe kompanisë së kontraktuar.

7. Përpunuesi është i detyruar të njoftojë kontrolluesin në rast cenimi të të dhënave personale. Përpunuesi nuk ka detyrimin që në këtë rast të njoftojë subjektin e të dhënave. Nëse përpunimi bëhet me nënkontraktim, kompania nënkontraktuese ka detyrimin që të njoftojë si kompaninë kontraktuese ashtu edhe kontrolluesin.

8. Kontrata me karakter *outsourcing* përmban dispozita që rregullojnë sa më poshtë:

a) Momentin kur përpunuesi njofton kontrolluesin për dëmin e shkaktuar ndaj:

i) subjektit të të dhënave, në rast të shkatërrimit, humbjes, ndryshimit, përhapjes së tyre të paautorizuar ose ndërhyrjes te të dhënat personale të transmetuara, të ruajtura apo të përpunuara;

ii) kontrolluesit, në rast të dëmeve që kanë lidhje me pozicionin e biznesit dhe reputacionin e kontrolluesit.

b) Njoftimin dhe kohën e kryerjes së tij. Njoftimi bëhet:

- pa vonesë;
- me shkrim;
- përmban të dhëna të plota në lidhje me llojin e cenimit të të dhënave dhe pasojat e këtij cenimi.

9. Për të përmbushur qëllimet e tyre, kontrolluesi dhe përpunuesi kanë mundësinë të zgjedhin që të bëjnë një kontratë të veçantë për përcaktimin e rregullave të mbrojtjes së të

dhënave personale, ose ta vendosin atë si pjesë të kontratës së tyre të biznesit. Për qëllimet e mbrojtjes së të dhënave personale, të dyja rastet janë të pranueshme, për sa kohë ato përcaktojnë rregulla të qarta dhe ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme të të dhënave personale dhe nivel sigurie në përputhje me legjislacionin shqiptar.

10. Kontrata e përpunimit siguron që:

a) përpunuesi përdor dhe përhap të dhënat personale vetëm sipas udhëzimeve të kontrolluesit;

b) përpunuesi merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave.

11. Moszbatimi i kërkesave të këtij udhëzimi, përbën shkelje të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe dënohet sipas nenit 39 të tij.

12. Për zbatimin e këtij udhëzimi detyrohen të gjithë kontrolluesit që hyjnë në një marrëdhënie kontraktore me një kompani të tretë për përpunimin e të dhënave personale.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERE
Flora Çabej (Pogaçe)